

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E MAMUSHËS**

Nr1 i prokurimit	626-23-2086-1-2-1
Nr i brendshëm	626-23-007-1-2-1

Sa i përket tenderit për: **“Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

TRIANGLE SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brigada 123

(Adresa)

Suharekë

(Vendi)

(Kodi postar)

049 473 653

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Ukë Baftjaraj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

triangle.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

02.06.2023

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

1. Njoftimi për kontrate i datës **29.03.2023**
2. Dosja e tenderit e datës **29.03.2023**
3. Procesverbali i hapjes i datës **18.04.2023**
4. Njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës **29.05.2023**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Procesverbali i hapjes eshte pranuar permes platformes se e-prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat perkatese te RrUOPP-se.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Te pa kënaqur me njoftimin e date 29.05.2023 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Mamushës në lidhje me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse" me nr. të prokurimit: 626-23-2086-1-2-1 dhe numër të brendshëm 626-23-007-1-2-1 në afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ushtrojmë këtë:

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Për shkak se AK- Komuna e Mamushës:

- Në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.)
- Në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik të pa përgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.)

Sqarojmë në mënyrë të detajuar :

Autoriteti Kontraktues **Komuna e Mamushës** me datën 29.05.2023 ka bërë publikimin e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku, në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar dhe ka rekomanduar për kontratë një OE me të shtrenjtte se neve në shumë gati prej 12,972.20€ (**çmimi i papeshuar**) dhe të pa përgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK-se të vendosura në NJK dhe DT.

Se pari po e faktojmë përgjegjshmërinë tone dhe kundërligjshmërinë e AK-se për të na eliminuar neve.

1. Autoriteti Kontraktues Komuna e Mamushes me datën 29.05.2023 na ka derguaar letrën standarde si tenderues i eliminuar me arsyetimin si me poshtë:

AK gjithashtu me date 18.05.2023 ka kërkuar nga ana jone sqarime per pozicione ku ju kemi përgjigjur me sqarime me datën 22.05.2023 edhe pas sqarimeve AK na ka eliminuar dhe ka dërguar ne KRPP B51 Njoftim per refuzim te tenderit abnormalisht te ulet - neni 61.

I bëjmë me dije AK-se se konform DT i kemi plotësuar te gjitha kërkesa dhe brenda afatit ju kemi përgjigjur sqarimeve per çmim dhe kemi qendruar prapa te gjitha çmimeve dhe kemi potencuar se kriteri i DT ka qen:

Kriteret e Dhënies	31.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët]; ☒ apo Pjesa A Funrizimi me artikuj nga pozicioni 1 deri 18 = 60% e pikëve në vlerësim Pjesa B Funrizimi me artikuj nga pozicioni 1 deri 25 = 30 % e pikëve në vlerësim Pjesa C Funrizimi me artikuj nga pozicioni 1 deri 74= 10 % e pikëve në vlerësim [Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6 ☐
--------------------	------	---

Pastaj kemi kerkuar nga AK; të zbatohen në tërësi kriteret e FDT-së.

Ju rikujtojm qe ju si AK ne leter standarden per informata mbi tenderin jo-normalisht te ulet keni kerkuar nga ne si OE te deklarojm qe sigurimin e ekzekutimit te rritet nga 6,500.00 € ne 13,000.00€ dhe pergjigja jon ka qen qe ne pajtohemi me rritjen e sigurimit ku edhe nje her ju kemi deshmuar qe ne qfardo rrethane qendrojm prapa çmimeve te cilave kemi ofertuar dhe jemi dhe neve jemi te gatshëm se nëse e nënshkruajmë kontratën qe ta implementojme këtë tender komplet sipas kërkesave dhe projektit te AK-se. Ju si AK edhe pasi keni kerkuar rritje sigurimit per te qen me te sigurt per kete projekt qe do te ekzekutohet ju perseri na keni eliminuar neve ne menyrt te pavedishme apo vetem per te demtuar buxhetin publik dhe duke e shkelur kriterin e DT pika 31.1 tenderi i pergjithshem me Çmimin me te ulet.

Prandaj ju sqarojm qe ky ka qen nje tentim i zyrtareve te Prokurimit dhe komisionit per ta demtuar buxhetin e Komunes ku kunderligjeshem i mudnesohet nje operatori te perfitoj nga buxheti i komunes dhe per te na demtuar neve drejt per se drejti pasi qe kemi ofertuar me tender te pergjegjeshem dhe me çmimin me te lirë.

Po ua faktojm vlersimin diskriminues te cilin e ka ber komisjoni se bashku me zyren e prokurimit duke vepruar me standarte te dyfishta dhe duke i **Shkelur edhe LPP** siç i kemi cekur më lart, prandaj ne munges te pervojës apo me vedije te plot komisjoni dhe ne menyrr diskriminuse ka vepruar ne kete menyrr ku neve si OE na ka kerkuar sqarime shites per pozivionet kinse me çmime teper te larta dhe quditrisht OE-se te shpallur fitues nuk ja ka kerkuar edhe kur çmimet kan qen te nejta apo edhe kur ne disa poozicione ka patur çmime ekstrem te lartat shih tabelen dhe ben krahasimet si ne shembullin e me poshtem dhe e sheh qart tendencen e komisjonit.

OE Triangle shpk			Bajram Ha. Gashi BI		
PJESA "A"	Pozicioni	çmimi	PJESA "A"	Pozicioni	çmimi
	11	40.00 €		11	30.00 €
	18	20.00 €		18	20.00 €

Po te marresh dhe ta analizon pershkrimin e pozicionit 11 dhe te mendosh qe eshte çmim i larte tek ne dhe çmim normal tek OE i shpallur fitues ose duhet te kesh munges pervoje ose duhet te kesh nje preferenc te caktuar per ndonjerin nga OE. Ne besojm me shume te kjo e dyta pra komisjoni ka patur nje preferenc (simpati) per OE te shpallur fitues, kete e fakton pozicioni i 18 ku çmimi ka qen i njejt ne oferta por quditrisht neve na eshte kerkuar sqarim shites si çmim i larte dhe OE fituese jo!!!!

- AK gjate vlersimit te ofertave quditrish nuk ka kerkuar sqarime shites per OE e shpallur fitues edhe per kunder qe ata ne disa pozicione kan patur çmime teper te larta, per pozicionet si ne vijim PJESA "A" pozicioni 4; PJESA "B" pozicionet 7; 8; 21; PJESA "C" pozicionet 18;19;23;38;67;70.

Pra nese merret dhe krahasohet vlersimi si e ka ber AK then te dyshosh qe keta nuk e kan qellim mbrojtjen e paras publike por qellimi i tyre eshte te bej diskriminim ndaj vlersimit te ofertave dhe te perzgjedhin nje OE te cilin ata e deshirojn edhe pse nuk i permbush kerkesat e FDT-se, ka çmime teper te larta ne disa pozicione dhe nuk eshte oferta totale me çmimin me te ulet sipas kerkeses se AK.

- Kompania jon si pale e demtuar ne menyrr siperfaqesore ka analizuar vetem dy projekte te cilat po kjo zyrr e prokurimit i ka lidhur me OE edhe kur ata kan patur çmime jonormalishte te ulta me tregun (pra po ua dokumentojm vetem disa kontrata edhe disa pozicione edhe pse ka me shume ne po i marrim vetem dy shembuj).

Projekti: Kubezimi dhe rregullimi i rrugeve lokale ne Mamushe me Nr prokurimi 626-22-8621-5-2-1

Poszicioni 1.2 Pastrimi i terenit..... 0.05 €/m²

Pozicioni 3.1 dhe 3.2 Zhavori 0-63mm dhe 0-31.5mm 3€/m²

Edhe per kunder qe keto çmime kan qen jonormalishte te ulta AK nuk e kan penguar per te lidhur kontrate.

Projekti: Servisimi, mirmbajtja dhe riparimi i automjeteve zyrtare te komunes se Mamushes me Nr prokurimi 626-21-3361-2-2-1

Pozicioni 3 – Regllazha.... per tipe te makinave te ndryshme. Fillon me çmime nga 2.5 € deri ne 5 €.

Pozicioni 114 – Koka e motorrit fillon nga 15€ deri 25€

Pozicioni 122 – Rrypi dhemzorr 18 €

Edhe per kunder qe keto çmime kan qen jonormalishte te ulta AK nuk e kan penguar per te lidhur kontrate.

Pra edhe ne shume kontrata tjera ka raste te shumta ku AK nuk i kan penguar as edhe nje çmim i ndonje pozicioni konkrte per te lidhur kontrate me operatoret ekonomik, ndersa ne rastin ton konkret perdor standarte te dyfishta.

2. AK ka rekomanduar per kontrate një OE te pa pergjegjeshem pasi qe nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT ku po i sqarojme vetem ato dokumete te cilat i kemi ne dispozicion pas qasjes ne dokumente, shih si me poshtë:

AK ka rekomanduar per kontrate ne OE te pa pergjegjeshem i cili nuk i ka plotesuar kerkesat e AK-se pasi qe OE i rekomanduar per kontrate nuk ka ofruar planin dinamik sipas kerkeses se AK:

Kushtet dhe kërkesat e dërgesës: DT pika 5.3 Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: në muaj **24** dhe piken 5.5 **-Afati i liferimit nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 (Pesë) ditë nga data e porosisë.**

Nese e merr dhe e analizon ate se qfar ka bashkangjitur ne ofert OE i shpallur fitues ai nuk eshte plan dinamik as afat kohor por eshte vetem nje deklarate me te cilen OE deklaronte qe liferimi i kontrates mund te behete per 5 dite gje qe eshte e pa mundur dhe joprofesionale dhe per mos permbushje te kesaj pike siq duhet eshte dashur qe ky OE te shpallet i papergjegjshem, shih deklaraten.

DEKLARATË

AFATI I LIFERIMIT

Me anë të kësaj deklarate në emër të kompanisë **Bajram Ha. Gashi B.L** ("N.N.P.,BG-ing")-Dubravë-Suharekë deklarojmë që do të respektojm afatin e liferimit prej pesë (5) ditësh nga data e porosisë konform dosjes së tenderit dhe siç kërkohet në FDT për projektin:

Titulli: "Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse"

Nr. i prokurimit: 626-23-2086-1-2-1 626-23-007-1-2-1

Me respekt:

N.N.P.,BG-ING"-Suharekë
Bajram Gashi



AK ka rekomanduar per kontrate ne OE te pa pergjegjeshem i cili nuk i ka plotesuar kereksat e AK-se pasi qe OE i rekomanduar per kontrate nuk ka dorzuar ANEKS 1 te DT:

Pra vet AK ka kerkuar ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUSHME dhe ne kete anesk ka vendosur pershkrimin e secilit pozicion pra nese ky aneks ka qen me specifikime teknike te detyrushme eshte dashur te nenshkruhet dhe vuloset te konfirmohet qe do te respektohen keto specifika teknike te detyrushme.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

5. **Operatori Ekonomik duhet te posedoj mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 8 të DT.***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
- 6.

Sipas kerkeses se DT obligative ka qen te plotesohet ne menyrt te drejt dhe sipas kerkeses Aneks 8 (pjesa e te dhenave per paisje) dhe nese nje aneks nuk plotesohet sipask kerkeses ai OE duhet te shpallet i papergjegjshem dhe ne rastin konkret ju mund te beni krahasime se si eshte plotesuar Aneks 8 nga ne dhe OE i shpallur fitues shih me posht.

Titulli: "Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse"

ANEKSI 8 LISTA E PAISJEVE

Nr.	Uloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar minimale (copë)	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhëna për pajisjet (viti prodhimit, gjendja e pajisjes, kategoria reth (targave, mekanizimi, dëshmitë mbi produkte ose kontratë për bluzim, foto etj)
1.	Kamionet	1 Copë	1	04-308 HM; viti 2004 - e mire
2.	Pikap per punëtor	1 Copë	1	04-481 JB; viti 2007 - e mire
3.	Kamion vetëshkarkues me kran me peshë bartëse 2-10 ton	1 Copë	1	01-824 LT; viti 1990 - E mire
4.	Kamion me korp me mekanizëm për bartje dhe ngritjen e shportës	1 Copë	1	04-401-GT; viti 2008 - E mire
5.	Skele levizëse per lartësi deri 5.5 m	1 Copë	2	S005_XIN_PR 7x10 - e mire S008_XIN_PR 2x15 - e mire
6.	Skele për ndërtimtari	5 Copë	11	367 Skele per ndertimtari - e mire
7.	Makin per thyerje dhe shpuarje (Hilt)	1 Copë	1	RT-RH 32 - e mire
8.	Flex prerëse	1 Copë	1	Flex Bosch GWS 20-230H - e mire
9.	Gjenerator	1 Copë	1	Gjenerator WKS 1800 Copper - e mire
10.	Prerëse për qeramika	1 Copë	1	IGMA 62 cm - e mire
11.	Përzirëse për ngjyrë	1 Copë	1	Flexirise per ngjyr spirale 1200 Wat - e mire

Emri i OE:	TRIANGLE SH.P.K
Adresa e plotë:	Rr. BRIGADA 123 pr SUHAREKË
I përfaqësuar nga:	
Emri dhe Mbledhja:	ARIAN BYTYCI
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	18.04.2023
Vula:	

Titulli: "Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse"

ANEKSI 8 LISTA E PAISJEVE

Nr.	Uloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar minimale (copë)	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhëna për pajisjet (viti prodhimit, gjendja e pajisjes, kategoria reth (targave, mekanizimi, dëshmitë mbi produkte ose kontratë për bluzim, foto etj)
1.	Kamionet	1 Copë	2 Copë	
2.	Pikap per punëtor	1 Copë	2 Copë	
3.	Kamion vetëshkarkues me kran me peshë bartëse 2-10 ton	1 Copë	1 Copë	
4.	Kamion me korp me mekanizëm për bartje dhe ngritjen e shportës	1 Copë	1 Copë	
5.	Skele levizëse per lartësi deri 5.5 m	1 Copë	1 Copë	
6.	Skele për ndërtimtari	5 Copë	5 Copë	
7.	Makin per thyerje dhe shpuarje (Hilt)	1 Copë	1 Copë	
8.	Flex prerëse	1 Copë	1 Copë	
9.	Gjenerator	1 Copë	1 Copë	
10.	Prerëse për qeramika	1 Copë	1 Copë	
11.	Përzirëse për ngjyrë	1 Copë	1 Copë	

Emri i OE:	BAJRAM HA.GASHI B.I (NNP,,BG-ing")
Adresa e plotë:	Dubravë - Suharekë
I përfaqësuar nga:	
Emri dhe Mbledhja:	Bajram GASHI
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	17.04.2023
Vula:	

Sqarim: Të gjitha pajisjet e ofruara janë në gjendje të mirë operacionale.

Pasi qe ne qasjen e dokumenteve ne nuk patem mundsi te marrim te gjitha dokumentet e OE te shpallur fitues pasi qe i njeiti ka plotesuar kerkesen per sekretet afariste mirpo nga ato pak dokumente qe ne morem vrejtem qe ato skan qen te plotesuara siq duhet dhe pikerisht tek aneks 8 ku edhe vet AK ka kerkuar sqarime shtes per makinerin per OE e shpallur fitues, pra ky OE eshte dashur te shpallet i papergjegjshem ne momentin qe nuk e ka te plotesuar ne menyrt te drejt Aneks 8 mirpo mungesa e profesionalizmit apo preferenca e komisionit per kete OE i ka detyruar ata te i mbyllin syte dhe te kalojn kete aneks per te kerkuar sqarime shtes per makineri.

Pra nese merret dhe krahasohet vlersimi si e ka ber AK tben te dyshosh qe keta nuk e kan qellim mbrojtjen e paras publike por qellimi i tyre eshte te bej diskriminim ndaj vlersimit te ofertave dhe te perzgjedhin nje OE te cilin ata e deshirojn edhe pse nuk i permbush kerkesat e FDT-se.

Neve do ta kërkojmë te drejtën tone në çdo Organ te Republikës se Kosovës qofte ato Administrative apo edhe Penale pasi qe po na mohohet e drejta jone ligjore ne mënyrë te kundërligjshëm dhe haptas AK na diskriminon neve dhe e favorizon një OE tjetër duke tentuar qe te keqpërdoren dhe te përfitoj kundërligjshëm dikush nga buxheti publik dhe te dëmtohet buxheti i Komunës se Mamushes.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Shihet qarte se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së ku në pikën 1 thuhet se : *Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Si dhe në pikën 2 thuhet :

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

AK për këtë aktivitet të prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe nenin 60 të LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

AK për këtë aktivitet të prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve e ka bërë në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së pasi që kundërligjshëm na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe nenin 41.3 të Rregullores Nr.001_2022 për prokurimin publik.

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Besojmë se i kemi elaboruar me shumë se sa që duhet shkeljet e AK-së në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Kërkojmë nga AK që të respektoj në përpikëri dispozitat ligjore që janë në fuqi lidhur me këtë lloj të aktivitetit të prokurimit dhe të nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e grupit të Operatoreve Ekonomik : TRIANGLE SH.P.K ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **“Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”** me nr. te prokurimit: **626-23-2086-1-2-1** dhe numër te brendshëm **626-23-007-1-2-1** te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Mamushes.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Mamushes ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **“Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”** me nr. te prokurimit: **626-23-2086-1-2-1** dhe numër te brendshëm **626-23-007-1-2-1** dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim dhe pas rivlerësimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet mbi angazhimin ne përgatitjen e ofertave, sigurimin e ofertës, shpenzimet per shërbime te avokatisë dhe fitimin e humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.